

V E N D I M
Nr. 294, datë 12.5.2001

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIT NË FUSHËN E KARANTINËS
DHE TË MBROJTJES SË BIMËVE, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHETIT TË IZRAELIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 17 dhe 23, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1995, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e karantinës dhe të mbrojtjes së bimëve , ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Izraelit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

MARREVESHJE

NDERMJET

QEVERISE SE REPUBLIKES SE SHQIPERISE

DHE

QEVERISE SE SHTETIT TE IZRAELIT

PER BASHKEPUNIM

NE FUSHEN E KARANTINES DHE MBROJTJES SE BIMEVE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shtetit të Izraelit (me poshtë të quajtura "Pale Kontraktuese"),

DUKE DESHIRUAR të thellojnë bashkëpunimin dypalësh në fushën e karantines dhe mbrojtjes së bimeve, dhe

DUKE VLERESUAR rëndësinë e parandalimit të futjes së parazitëve karantinorë, me qëllim që të minimizojnë humbjet e prodhimit bujqësor, si dhe për lehtësuar tregtinë dypalëshe dhe shkëmbimin e mallrave me origjinë bimorë,

RANË DAKORT sa më poshtë:

Neni 1

Tërmat e përdorura në këtë Marrëveshje kanë këtë kuptim:

- a) bime – bimët e gjalla dhe pjesët e tyre, përfshirë farërat;
- b) produkte bimorë – prodhimet e papërpunuara me origjinë bimorë (përfshirë drithërat), si dhe prodhimet e përpunuara, që nga natyra e vet ose mënyra e përpunimit mund të krijojnë rrezik për futjen dhe përhapjen e parazitëve karantinorë;
- c) farëra – farëra për mbjellje por jo për konsum dhe përpunim;
- d) mallra me origjinë bimorë – artikuj të cituar në nenin 1 a), b) dhe c);
- e) parazit – çdo formë e gjallë e bimeve dhe kafshëve, ose çdo agjent patogjenik, i demshëm ose potencialisht i demshëm për bimët dhe produktet bimorë;
- f) parazitë karantinorë – parazitë të demshëm që kanë rëndësi ekonomike potenciale për vendin që rrezikohet prej tyre por që nuk janë hasur aty, ose që janë hasur por jo në shkallë të gjere dhe që janë aktivisht të kontrolluar.
- g) parazitë me rëndësi ekonomike – parazitë të përhapur nga një Pale Kontraktuese në tjetren, të cilët në rastin e mbishumezimit mund të shkaktojnë dëme të mëdha, luftimi i të cilëve mund të bëhet sipas rregullave.

Neni 2

Mëqenëse të dy Palet Kontraktuese janë antare të EPPO (Organizata Europiane dhe Mesdhetare e Mbrojtjes së Bimeve), ato pranojnë listën e parazitëve të publikuar nga EPPO dhe të pranuar nga IPPC (Konventa Nderkombetare për Mbrojtjen e Bimeve).

Neni 3

Organet kompetente te Paleve Kontraktuese do te informojne menjehere tjetren per shfaqjen e parazitëve karantinore te cituar ne listen e seciles Pale Kontraktuese, si dhe per masat e marra kunder erhapjes se tyre dhe masave te realizuara per crenjosjen e tyre.

Neni 4

Eksporti dhe tranziti i mallrave me origjine bimore nga territori i nje Pale Kontraktuese ne ose permes territorit te Pales tjetere Kontraktuese do te kryhet ne perputhje me legjislacionin per karantinën dhe mbrojtjen e bimeve te Pales tjetere Kontraktuese.

Neni 5

Pale Kontraktuese bien dakort qe ne rastin e eksportit te mallrave me origjine bimore ne territorin e Pales tjetere Kontraktuese, si material ambalazhues te perdoren p.sh. tallash, pluhur sharre, leter, material plastik dhe materiale te tjera te cilat nuk mund te trasferojne parazite karantinore. Keto mallra gjithashtu nuk duhet te permbajne dhë. Farat e eksportuara dhe bimët duhet te pakëtohen ne material ambalazhues te ri.

Mjetet e transportit te perdorura per transferimin e mallrave me origjine bimore ne territorin e Pales tjetere Kontraktuese duhet te jene te pastuara dhe, nese eshte e nevojshme, gjithashtu te dizinfektuara kunder parazitëve.

Neni 6

Do ngarkese e eksportuar e mallrave me origjine bimore e cila eshte subjekt i inspektimit fitosanitar duhet te jete e shoqeruar nga nje certifikate fitosanitare, e leshuar nga nje njesi e sherbimit te mbrojtjes e bimeve dhe karantines, qe konfirmon se keto mallra jane te pastra nga parazitët te cilet konsiderohen karantinore nga Pala tjetere Kontraktuese.

Prania e certifikates fitosanitare nuk perjashton te drejten e Pales Kontraktuese importuese per te bere inspektimin fitosanitar te mallrave me origjine bimore dhe per te marre masat e nevojshme.

Organet kompetente te Paleve Kontraktuese mund te percaktojne kerkesa fitosanitare shtese ne rastin e importit te mallrave te ndryshme me origjine bimore.

Neni 7

Palet Kontraktuese duhet te informojne njera tjetren per pikat kufitare te kalimit ne territorin e tyre permes te cilave kryhet ose eshte i lejuar eksporti, importi, tranziti i mallrave me origjine bimore.

Neni 8

Nese, gjate inspektimit fitosanitar, gjendet nje parazit karantinor, ose konstatohen shkelje te rregullave te karantines se bimeve te vendit importues, atehere organet kompetente te Paleve Kontraktuese kane te drejte te refuzojne importimin e ketyre mallrave me origjine bimore, ose t'i shkaterrojne ato, ose te marrin masa fitosanitare te tjera urgjente.

Neni 9

Palet Kontraktuese angazhohen te mbikqyrin kushtet e kesaj Marreveshje gjate shkembimeve te mallrave me origjine bimore te ndryshme, perfshire dhuratat dhe shkembimet per qellime shkencore, pa perjashtuar rastet kur te tilla mallra jane derguar nepermjet kanaleve diplomatike.

Neni 10

Organet kompetente te Paleve Kontraktuese, nese eshte e nevojshme, do t'i sigurojne njeri tjetrit eksperte, asistence teknike etj. ne fushen e karantines dhe te mbrojtjes se bimeve ne perputhje me Marreveshjen.

Neni 11

Organet kompetente te Paleve Kontraktuese do te:

- a. Informojne njeri tjetrin per ligjet dhe rregulloret e tjera qe kane te bejne me karantinen dhe mbrojtjen e bimeve ne Shtetet e tyre respektive, te pakten brenda tre muajve nga data e hyrjes ne force te tyre.
- b. Te informojne njeri tjetrin per gazetate profesionale dhe te specializuara, monografet dhe publikime te tjera ne fushen e karantines dhe te mbrojtjes se bimeve te botuara ne Shtetet e tyre respektive.

Neni 12

Me qellim qe te lehtesohet transporti dhe per te zvogeluar rrezikun e hyrjes se paraziteve karantinore, mund te kryhet inspektimi fitosanitar nga organet kompetente te njeres Pale Kontraktuese ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese, nese te dy palet bien dakort per kete.

Procedura dhe kushtet e tjera te inspektimit fitosanitar do te percaktohen nga organet kompetente te Paleve Kontraktuese ne nje marreveshje te vecante per cdo rast individual.

Neni 13

Organet kompetente te Paleve Kontraktuese do te takohen, nese eshte e nevojshme, per konsultime te perbashketa, per te trajtuar probleme praktike qe kane te bejne me zbatimin e kesaj Marreveshje.

Takimet do të zhvillohen në mënyrë të alternuar në Republikën e Shqipërisë dhe në Shtetin e Izraelit. Data dhe vendi i konsultimeve do të përcaktohen me pëlqim dypalësh.

Secila Pale Kontraktuese do të mbulojë shpenzimet e veta kur vizitat konsultative behen në të dy Shtetet respektive.

Neni 14

Organet kompetente të Paleve Kontraktuese përgjegjëse për koordinimin e zbatimit të kësaj Marreveshjeje janë:

për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë – Drejtoria e Sherbimit të Mbrojtjes së Bimëve, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të Republikës së Shqipërisë;

për Qeverinë e Shtetit të Izraelit – Sherbimi i Inspektimit dhe Mbrojtjes së Bimëve, Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural të Shtetit të Izraelit.

Neni 15

Parashikimet e kësaj Marreveshjeje janë të pavarura nga çdo e drejtë dhe detyrim që Palet Kontraktuese mund të kenë si rezultat i marreveshjeve që janë bërë me shtete të tjera, ose nga antaresimi në organizata ndërkombëtare e kombëtare për karantinën dhe mbrojtjen e bimëve.

Neni 16

Opinionet e ndryshme ndërmjet Paleve Kontraktuese që vijnë si rezultat i interpretimit ose zbatimit të ndryshëm të kësaj Marreveshjeje do të zgjidhen nga një Komitet i Perbashket i zgjedhur me pëlqim të përbashket. Nëse Komiteti i Perbashket nuk është i aftë të gjejë një zgjidhje, çështja do të zgjidhet me rrugë diplomatike.


Neni 17

Kjo Marreveshje është subjekt për aprovim ose ratifikim në përputhje me procedurat ligjore të brendshme të Paleve Kontraktuese dhe do të hyjë në fuqi në datën e njohimit të dytë diplomatik që ka të bëjë me këtë aprovim ose ratifikim.


Çdo shtesë ose modifikim i Marreveshjes do të ndjehet të njëjten procedurë si hyrja në fuqi e saj.

Kjo Marreveshje do të jetë e vlefshme për një periudhë prej pesë (5) vjetësh. Pas kësaj vlefshmerie e saj automatikisht do të zgjatet edhe për periudha të tjera pesë (5) vjeçare secila, derisa njëra prej Paleve Kontraktuese e denoncon atë me shkrim, të pakten gjashtë (6) muaj para skadimit të periudhës përkatëse.

BERE ne Jerusalem me 9 Janar 2001, e cila korrepondon me 13 Tevet 5761, ne tre kopje origjinale, shqip, hebraisht dhe anglisht, te tre tekstet jane njelloj autentikisht. Ne rastin e divergjencave ne interpretim teksti anglisht do te mbizoteroje.



PER QEVERINE E
REPUBLIKES SE SHQIPERISE



PER QEVERINE
E SHTETIT TE IZRAELIT